



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT DHE BURIMEVE NJERËZORE
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE PROTOKOLL - ARKIVËS

NJOFTIM

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, bazuar në Urdhërin Nr. 60, datë 04.09.2019 të Rektorit, *shpall* njoftimin për konkurim të hapur, për vendin e lirë të punës në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë:

PERSONEL AKADEMIK ME KOHË TË PLOTË PER GJUHEN ANGLEZE

1 (një) personel akademik me angazhim me kohë të plotë

Përshkrimi i vendit të punës

Personeli akademik me kohë të plotë që do të punësohet do të zhvillojë kurse të gjuhës angleze për nivele të ndryshme dhe kurse të gjuhës angleze për qëllime të posaçme. Duke qenë se këto kurse kanë në fokus të tyre zhvillimin e katër shprehive (lexim, dëgjim, të shkruarit, të dëgjuarit), me orientim kryesor zhvillimin e aftësive komunikuese në gjuhën angleze dhe prezantimin e elementeve tipikë të kulturës angleze, përparësi do t'u jepet kandidatëve që dëshmojnë një nivel të lartë të zotërimit të gjuhës dhe kulturës angleze.

Kritere të përgjithshme që duhet të plotësoj/në kandidati/ët

- Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkuron;
- Të jetë i aftë të garantoj standartin e cilësisë dhe efikasitetin në mësimdhënie.
- Të ketë aftësinë e punës në grup dhe të komunikimit profesional me kolegët dhe studentët;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të Gjykatës për kryerjen e një vepre penale si dhe të mos jetë person nën hetim;
- Kandidati nuk duhet të ketë patur background negativ në eksperiencat e mëparshme në punë;
- Të mos jetë marrë ndaj tij masë disiplinore "largim nga puna" si dhe të mos jetë në proces gjyqësor me Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë;
- Të mos ketë vepruar ose propaganduar në drejtim të prishjes së imazhit të universitetit dhe autoriteteve drejtuese të UV-së, në median vizive dhe/apo të shkruar, rrjetet sociale etj.

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë i aftë nga ana shëndetësore;
- Të ketë eksperiencë në punë.

Kriteret e seleksionimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve:

1. Të zotërojnë së paku diplomë të studimeve universitare “Master i shkencave” në fushën e kërkuar.
2. Përparësi do t’u jepet kandidatëve që dëshmojnë nivelin më të lartë të zotërimit të gjuhës dhe kulturës angleze dhe nivelin më të lartë të kualifikimit.
3. Parapëlqehen kandidatë me kualifikime të fituara në universitete perëndimore, të njësuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit bazuar në nenin 92 të ligjit nr. 80/2015.
4. Nota mesatare e cikleve të studimit (cikli i parë dhe i dytë) të kandidatit të jetë jo më pak se 8.5.
5. Parapëlqehen kandidatë që kanë përvojë universitare në mësimdhënie dhe që kanë një vlerësim pozitiv të paraqitjes akademike dhe institucionale.
6. Vlerësohen më së shumti kandidatët me eksperiencë studimi dhe mësimdhënieje në universitetet perëndimore.
7. Të kenë aftësi komunikuese dhe për të punuar në grup. Kandidati duhet ta dëshmojë këtë me përfshirjen në aktivitete që kërkojnë të punuarit në skuadër.
8. Të kenë aktivitet kërkimor-shkencor në fushën përkatëse të studimit (gjuhë, kulturë, mësimdhënie në gjuhën angleze dhe/ose disiplina të tjera të ngjashme me to).
9. Vlerësohen kandidatët që kanë qenë të përfshirë në projekte kërkimore, akademike dhe zhvillimore. Kandidati duhet ta dëshmojë këtë me dokumentacion mbështetës (dëshmi pjesëmarrjeje, punime apo prezantime të bëra në këto kuadro etj.).
10. Veprimtari dhe/ose kualifikime të tjera përpos atyre nga fushat e cituara më sipër, por që sjellin një lloj impakti tek to dhe që dëshmojnë dëshirën dhe vullnetin e kandidatit për të përparuar në dije do të merren në konsideratë.

Pikëzimi i sugjeruar sipas kriterëve të përcaktuara më sipër:

Nr.	Emërtimi	Kriteret e vlerësimit
1.	Diploma “Master” në studime gjuhësore, letrare dhe kulturore në gjuhë të huaj	15 pikë
2.	Diploma “Doktor i shkencave”	30 pikë
3.	Titulli “Profesor i asociuar”	40 pikë
4.	Titulli “Profesor”	45 pikë
5.	Nota mesatare e përgjithshme	0,5 pikë për çdo notë në intervalin 8.5-10
6.	Nota mesatare e formimit profesional	1 pikë me intervalin 8.5 – 10
7.	Përvojë në mësimdhënie universitare	1 pikë për çdo vit pune

8.	Përvojë në kërkim shkencor	1 pikë për çdo pjesëmarrje në projekt kërkimor dhe/ose projekt evropian, konferencë shkencore, seminar shkencor 1 pikë për çdo artikull shkencor të botuar brenda vendit ose vende të rajonit, udhëheqje doktorate, oponentë doktorate 2 pikë për çdo artikull shkencor të botuar në vende të Be-së/OECD-së, organizim konference shkencore, seminar shkencor, përkthim vepre letrare 5 pikë për çdo monografi ose vëllim shkencor
9.	Kualifikime pasuniversitare në studime gjuhësore, letrare dhe kulturore në gjuhë të huaj	1 pikë për çdo kualifikim
10.	Përvoja të tjera (shkëmbime stafi, mësimdhënie në universitete të huaja)	1 pikë për çdo semestër
11.	Veprimtari dhe/ose kualifikime të tjera përpos atyre nga fushat e cituara më sipër	1 pikë për çdo 6 muaj kualifikim
12.	Njohje e gjuhës së huaj (e certifikuar)	1 pikë për çdo notë mbi 7
13.	Dëshmi të aftësive kompjuterike	1 pikë
14.	Përvojë pune e mëparshme pranë UV-së (pranë Departamentit të Gjuhëve të Huaja)	1 pikë për çdo vit pune pranë UV-së
15.	Eksperiencia të tjera pune	0.5 pikë për çdo vit pune
16.	Aftësi komunikuese dhe për të punuar në grup	1 pikë për çdo trajnim, projekt ose aktivitet/workshop ku është angazhuar
17.	Intervista	10 pikë

Dokumentacioni i kërkuar

- Formulari i aplikimit i plotësuar nga aplikanti. Gjendet në adresën www.univlora.edu.al
- Jetëshkrim/ CV;
- Diploma/t universitare (kopje e noterizuar);
- Lista e notave e studimeve universitare (origjinal);
- Tituj akademik ose grada shkencore (kopje e noterizuar);
- Dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve, arsimim shtesë, apo të tjera të përmendura në jetëshkrim (kopje të noterizuara);
- Artikuj të botuar, projekte shkencore, etj;

- Dëshmi të pjesëmarrjes në konferenca, seminare, *workshop-e*, etj (kopje të noterizuara);
- Libreza e punës (original ose kopje të noterizuar)
- Raport mjekësor për aftësinë në punë, lëshuar 3 muajt e fundit (original);
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dokument origjinal i lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë);
- Fotokopje të kartës së identitetit ID;

Shënim:

Diplomat, certifikatat, gradat dhe titujt e fituar në institucione të huaja arsimore, të shoqërohen me certifikatën e njehsimit, bazuar në nenin 92 të Ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

Mënyra e aplikimit

Dokumentat duhet të dorëzohen **vetëm nëpërmjet shërbimit postar** në adresën:



**- Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë,
Lagjja. "Pavarësia", Rr. "Kosova"
9400 Vlorë, Shqipëri.
-Drejtorja e Komunikimit dhe e
Burimeve Njerëzore.
-Personel akademik me kohë të plotë
për gjuhën angleze**

Afati për aplikim

- ✓ Afati për të aplikuar është 2 dy (javë) kalendarike. Ky afat fillon nga data e nesërme e publikimit të njoftimit në web-site zyrtar të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë: www.univlora.edu.al. (njoftimi u publikua në datën 04.09.2019 dhe afati përfundon në datën 19.09.2019).
- ✓ Dokumentacioni i dorëzuar në shërbimin postar pas datës 19.09.2019, do t'i kthehet aplikantit pa veprime.

Procedura e punësimit të personelit akademik

- ✓ Punësimi i personelit akademik në UV bëhet me konkurs.
- ✓ Konkurimi do të kryhet në dy faza: vlerësimi i dosjes dhe intervista e drejtëpërdrejtë e kandidatit.
- ✓ Dokumentacioni i dorëzuar nga aplikanti në kundërshtim me kërkesat e shpallura, nuk do të merret në konsideratë nga Komisioni *ad hoc*. Vlerësimi do të kryhet vetëm mbi bazën e dokumentacionit të konsideruar të vlefshëm.
- ✓ Komisioni *ad hoc* njofton kandidatët për rezultatet e vlerësimit të fazës së parë.
- ✓ Ankesat në lidhje me vlerësimin e kandidatëve dhe zbatimin e procedurave nga komisioni *ad hoc*, paraqiten te Rektori brenda 5 (pesë) ditëve.

- ✓ Kandidatit i lind e drejta e ankimit nga e nesërmja e njoftimit të vendimit për fazën e parë të vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar. Në këtë rast, Rektori urdhëron komisionin *ad-hoc* për pezullimin e procedurës së konkurimit deri në përfundimin e procedurës së shqyrtimit të ankimit. Kur vlerëson se ankimi është i pranueshëm, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të ankimit, Rektori vendos me një akt të ri anulimin, shfuqizimin ose ndryshimin e vendimit të komisionit *ad-hoc*. Vendimi i rektorit i njoftohet komisionit *ad-hoc* i cili në vijim cakton datën dhe njofton kandidatët fitues për zhvillimin e intervistës me gojë.
- ✓ Kandidati i cili kalon fazën e parë të kualifikimit të dosjes, por nuk paraqitet në fazën e dytë të intervistës me gojë, skualifikohet nga konkurimi.
- ✓ Komisioni *ad hoc* vlerëson dhe rendit kandidatët konkurues sipas pikëzimit të vendosur në rregulloren e UV-së dhe ia përcjell Rektorit i cili vendos në mënyrë përfundimtare mbi secilën kandidaturë.
- ✓ Kundër vendimit të fazës së dytë për vlerësimin e intervistës, kandidati ka të drejtën e ankimit brenda 5 (pesë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi. Në këtë rast, Rektori urdhëron shqyrtimin e ankimit. Kur vlerëson se ankimi është i pranueshëm, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të ankimit, rektori vendos me një akt të ri anulimin, shfuqizimin ose ndryshimin e vendimit të komisionit *ad-hoc*.
- ✓ Vendimi përfundimtar i Rektorit për miratimin e klasifikimit përfundimtar dhe shpalljen e fituesit, i njoftohet palëve të interesuara.
- ✓ Rektori emëron kandidatin fitues dhe nënshkruan kontratën e punës.

Pergjegjes Sektori

Erdeta Breshanaj